



AKT THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"N.N.S H K O Z A" SH.P.K.

Ne Tirane, sot, me 30.5 1994 z.BERNARD SHKOZA, i biri i Gjekes i dtl.1949, lindur dhe banuese ne Shkoder, rruga "3 Heronjte" nr.6, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar deklarom ne kete akt themelimi si me poshte vijon:

NENI 1

Ortaku i vetem BERNARD SHKOZA vendos per krijimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar te emertuar "N.N.SHKOZA " SH.P.K.

NENI 2

Kjo shoqeri me pergjegjesi te kufizuar eshte person juridik ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe aktiviteti i saj rregullohet sipas dispozitave te statutit te kesaj shoqerie dhe duke u bazuar edhe ne kete akt themelimi si dy akte baze te kesaj shoqerie.

NENI 3

Qendra e kesaj shoqerie do te jete ne qytetin e Tiranes me adresen e saj rruga "3 Heronjte" nr.6 ne Shkoder, me te drejte per te ndryshuar qendren e saj, si edhe per te hapur dege edhe filiale te tjera ne te gjithë Republikën e Shqipërisë si edhe jashte saj, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 4

Kapitali fillestar i kesaj shoqerie do te jete i perbere nga nje shume prej 415.861 lekesh, i cili perben kontributin e plote te themeluesit, te kesaj shoqerie.

NENI 5

Kohezgjatja e kesaj shoqerie do te jete me nje afat kohe mbi 10 vjet.Por e cila edhe mund te shperbehet me pare sipas rasteve te parashikuara ne kete statut(shperberja dhe likuidimi).

NENI 6

Objekti i aktivitetit te kesaj shoqerie eshte percaktuar me hollësi ne nenin 4 te statutit te kesaj shoqerie.Keshtu konkretisht kjo shoqeri do te ushtroje aktivitetin e saj ne fushen e :ndertimit te objekteve industriale, banesa, hoteleri, turizem, prodhim dhe tregetim te pjeseve te ndertimit, transport mallrash, punime restaurimi, si edhe kompletimin dhe instalimet e nevojshme etj.

NENI 7

Fillimin e aktivitetit te saj tregtar kjo shoqeri e lidh me regjistrimin e saj ne regjistrin tregetar te Gjykates se rrethit Tirane si edhe me paisjen me licence nga Zyra e Tatimeve Shkoder.

NENI 8

Aktiviteti ekonomik dhe investimet e kesaj shoqerie mbrohen nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

NENI 9

Administrator i pergjithshem i kesaj shoqerie eshte themeluesi i saj z.BERNARD SHKOZA, i cili ushtron dhe ndjek aktivitetin e shoqerise te krijuar prej tij duke zbatuar edhe kompetencat perkatese sipas dispozites perkatese te statutit.

NENI 10

Per ruajtjen dhe sigurimin e pasurive te saj te luajtshme dhe te paluajtshme kjo shoqeri mund t'i drejtohet INSIG- ut ne qender dhe ne deget e saj.

NENI 11

Dispozita me te hollesishme jane parashtruar dhe parashikuar ne statutin e kesaj shoqeri e cila shpreh vullnetin e lire te themeluesit.

AVOKATE
VILOANDA BEBI
TIRANË

Tirane, me 30.5.1994

SHOQERIA ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"N.N. S H K O Z A"SH.P.K.

/ BERNARD SHKOZA /



STATUT

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

" N.N. SHKOZA " sh.p.k.

Ne mbeshtetje te ligjit "PER SHOQERITE TREGETARE" Nr.7638 date 19.11.1992 z.BERNARD GJEK SHKOZA, banues ne qytetin e Shkodres, rr."3 Heronjte" nr 2 me vullentin e tij te lire e te plote, deklaroi si me poshte vijon:

KREU I
FORMIMI I SHOQERISE " N.N.SHKOZA " sh.p.k.

NENI 1

Deklarohet e formuar Shoqeria me Pergjegjesi te kufizuar me themeluesin dhe ortakun e saj te vetem z.BERNARD SHKOZA, i biri i Gjekes, i dtl.1949, banues ne qytetin e Shkodres me adresen e mesiperme.Kjo shoqeri mund te cele edhe dege dhe filiale te saj edhe qytete te tjera te vendit.

KREU II
EMERTIMI I SHOQERISE

NENI 2

Shoqeria e cila eshte formuar nga ortaku i saj i vetem emertohet me emrin e saj "N.N.S H K O Z A " e cila eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, me inicialet sh.p.k., iniciale te cilat do te shoqerojne kudo emrin e kesaj shoqerie.Ajo do te kete edhe vulen e saj e cila do te shoqeroje te gjithë dokumentacionin e nxjerre nga kjo shoqeri.

KREU III
SELIA E SHOQERISE

NENI 3

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar e emertuar si me siper " N.N.SHKOZA"sh.p.k. do kete qendren si edhe seline e saj ne qytetin e Shkodres rruga "3 Heronjte" nr.2, qender e cila mund te ndryshoje.

KREU IV
KAPITALI FILLESTAR

NENI 4

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar e mbeshtet fillimin e aktivitetit te saj ne nje kapital fillestar prej 415,861 leke shume e cila eshte e depozituar

prane Bankes Tregetare Shqiptare dega e Shkodres. Ky kapital perben kontributin e vetem te ortakut te vetem dhe themelues te kesaj shoqerie. Kapitali i kesaj shoqerie mund te shtohet me pjesmarrje te reja per te ndiqet edhe procedura per regjistrimin e tyre, ose edhe mund te pakesohet.



**KREU V
KOHEZGJATJA E SHOQERISE**

NENI 5

Kjo shoqeri aktivitetin e saj do ta zhvilloje per nje periudhe kohe mbi 10 vjet. Por kjo shoqeri mund te shperbehet edhe para mbarimit te ketij afati, shperberje e cila mund te behet ne zbatim te dispozitave perkatese te ketij statuti, per cdo rast tjeter apo edhe sipas legjislacionit Shqiptar ne fuqi per kete qellim.

**KREU VI
OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

NENI 6

Aktivitetin e saj kjo shoqeri e mbeshtet ne keto drejtime :ndertim te objekteve industriale, banesa, hoteleri, turizem, prodhim edhe tregetim te pjeseve te ndertimit, lende te para dhe materiale ndihmese per ndertim, transport te mallrave, punime restaurimi, si dhe kompletimin dhe instalimet e nevojshme etj.

**KREU VII
ADMINISTRIMI I SHOQERISE**

NENI 7

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar e zhvillon aktivitetin e saj duke u administruar nga **ADMINISTRATORI** i saj i pergjithshem qe eshte edhe vete themeluesi i kesaj shoqerie z.**BERNARD SHKOZA**.

**KREU VIII
ORGANIZIMI I SHOQERISE**

NENI 8

Ne organizimin dhe ecurine e aktivitetit te saj kjo shoqeri drejtohet nga **ORGANI VENDIMOR** i saj qe eshte **ASAMBLEA**, organ i cili udhehiqet nga ortakut i saj i vetem. Vendimet e marra nga kjo asamble, qe vijne ne harmoni me dispozitat e ketij statuti si edhe te aktit te themelimit, jane te detyrueshme per te gjithet anetaret e shoqerise.

KOMPETENCAT E ASAMBLESE

NENI 9

Asambleja gjate kryerjes se aktivitetit te saj do te kete keto kompetenca :

- Te miratoje bilancet 3 mujore dhe vjetore te aktivitetit financiar, jo me vone se nje muaj nga mbylljet kalendarike.

- Te caktoje rregullin e brendshem te punes.

- Te caktoje dhe miratoje numrin e punonjesve, pagat e tyre si edhe kushtet e marrjes se tyre ne pune.

- Te analizoje, veprimtarine mujore dhe vjetore si edhe te percaktoje drejtimit e zgjerimit te aktivitetit.

- Te miratoje kontratat e nevojshme per zhvillimin e aktivitetit, veprimtarine financiare me persona fizike dhe juridike vendas dhe te huaj.

- Te percaktoje tarifat e sherbimeve te ndryshme qe do te kryhen gjate zhvillimit te aktivitetit sipas objektit te dhene me siper.

- Te miratoje dhe drejtoje komisionin per likuidimin e kesaj shoqerie.

NENI 10

Ortaku i kesaj shoqerie eshte njekohesisht edhe drejtues ekzekutiv. Per demet qe i shkaktohen kesaj shoqerie, per shkak te drejtimit, per shkeljen e statutit dhe te aktit te themelimit, ortaku i vetem do te mbaje pergjegjesi individualisht.

**KREU IX
PERFAQESIMI I SHOQERISE**

NENI 11

Ortaku i vetem i kesaj shoqerie perfaqeson kete shoqeri ne te gjitha marrredheniet me organet shteterore, gjyqesore, financiare apo private.

Me vendim te Asamblese se kesaj shoqerie per veprime te ndryshme, apo probleme te vecanta gjate kryerjes se aktivitetit te saj me prokure te pergjithshme apo te posacme caktohet nje person i cili mund te jete punonjes ose jo ne kete shoqeri, person i cili do te ngarkohet per te kryer veprime te ndryshme, te cilat do jene te parashikuara dhe te percaktuara ne keto prokura.

**KREU X
ADMINISTRIMI I TE ARDHURAVE**

NENI 12

Per administrimin e te ardhurave, ne zhvillimin e aktivitetit kesaj shoqerie, do te caktohet nje ekonomist, i cili do te kryeje te gjitha veprimet financiare te nevojshme per evidentimin e te ardhurave te realizuara, fitimit te arritur, si edhe detyrimeve etj. ne lidhje me keto. Te ardhurat do te evidentohen ne librat e llogarise me llogarite e saj te vecanta, keshtu konkretisht do te behet llogaritja e te ardhurave te pergjithshme, te realizuara, duke zbritur keshtu tatimin mbi qarkullimin tatimi mbi fitimin, si

Handwritten signature

edhe te gjitha likujdimet e taksave te tjera te nevojshme te percaktuara ne legjislacionin shqiptar ne fuqi, pagat e punonjesve, dhe fitimi i mbetur pas te gjitha ketyre veprimeve do te kaloje per shtimin dhe zgjerimin apo cuarjen me tej te aktivitetit te kesaj shoqerie.

NENI

13

Viti financiar eshte nga i Janari deri me 31 Dhjetor. Fitimi i realizuar i kalon per administrim dhe pronesi ortakut apo themeluesit te kesaj shoqerie me miratimin e bilancit vjetor. Pagat, kuotat e shperblimeve paguhen ne leke apo ne valute te huaj. Dhenia e shperblimeve dhe e ndihmave materiale ne rastete vecanta behen sipas buxhetit dhe do te miratohet nga ortakut.

Veprimet bankare te kesaj shoqerie do te kryhen vetem nga ortakut i vetem i kesaj shoqerie. Por per raste te vecanta te miratuar nga ortakut i saj i vetem keto veprime apo disa prej tyre mund te kryhen edhe nga persona te tjere, per te cilet eshte leshuar prokure e nenshkruar prane Zyres se Noterise Tirane, si edhe ne zbatimin te rregullave qe ka vete institucioni bankar per kete ceshtje.

KREU

XI

MARREDHENIET E PUNES DHE RREGULLIMI I TYRE

NENI

14

Kjo shoqeri ka te drejte te punesoje prane saj shtetas shqiptar apo te huaj, keta te punesuar mund te jene me aresim te mesem apo te larte, ne varesi kjo te nevojave qe do te kete kjo shoqeri, mund te jene specialiste te larte apo te mesem te fushave te ndryshme te ekonomise.

Marredheniet me te punesuarit kjo shoqeri i krijon dhe i lidh nepermjet kontratave te punes te cilat mund te jene individuale apo kolektive, kontrata te cilat do te lidhen ne zbatim me dispozitat e ketij statuti dhe te legjislacionit shqiptar te punes qe eshte ne fuqi.

NENI

15

Te gjitha mosmarreveshjet e krijuara midis punedhenesit dhe te punesuarit, ne rastet kur nuk zgjidhen me mirekuptim midis paleve kompetente per zgjidhjen e tyre do te behet Gjykata e rrethit ku ka qendren e saj kjo shoqeri, Shkoder.

KREU

XII

SEKRETI AFARIST

NENI

16

Do te quhen si sekret afarist te gjitha ato dokumenta apo akte te cilesuara si te tilla nga themeluesja e kesaj shoqerie, nga ortakut i vetem i saj si edhe nga Asambleja si organ vendimor i kesaj shoqerie.

KREU, XIII
SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI I SAJ

NENI 17

Kjo shoqeri e ndryshon aktivitetin e dhe menyren e organizimit te saj me ane te shperndarjes, dhe rastet kur kjo shoqeri nuk e ushtron aktivitetin e saj ose ne raste te force madhore, po keshtu dhe ne formen e likujdimit. Per likujdimin e saj me vendim te oraganit te saj vendimor, qe eshte Asamblea krijohet komisioni i Likujdimit te shoqerise i cili harton dhe perpilon bilancin e likujdimit te kesaj shoqerie dhe e paraqet ate per miratim nga ana e asamblese, e cila pasi e shqyrton dhe e quan te rregullt vendos shpalljen e saj. Pas shpalljes se ketij bilanci, nga ana e ortakut te vetem te kesaj shoqerie kryhen te gjithaveprimet e nevojshme per c'regjistrimin e kesaj shoqerie nga regjistri tregetar i Gjykates se rrethit ku ajo eshte regjistruar si edhe ne zyren e tatimeve te rrethit.

KREU XIV
NDRYSHIMET NE STATUT

NENI 18

Kjo shoqeri gjate zhvillit teaktivitetit te saj mund te shoqerohet me ndryshime te cilat mund te jene per probleme te ndryshme, shtimit apo pakesimit te objektit te veprimtarise apo ndryshimit te legjislacionit perkates per kete qellim. Keshtu konkretisht me vendim te Asamblese apo te ortakut te saj te vetem mund te ndryshohen ne statut objekti i saj, qendra, kapitali, pjesemarrja ne te e cila mund te shtohet, kohezgjatja e saj. po keshtu edhe te gjitha ndryshimet qe do te pesoje legjislacioni shqiptar ne fuq i per kete qellim do te pasqyrohet edhe ne dispozitat e ketij statuti.

AVOKATE
VILOANDA BEBI
TIRANE

" N.N. SHKOZA " sh.p.k.
ORTAKU I VETEM

/ BERNARD SHKOZA /

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
NOTERIA

NR. 5592 REP
NR. 2318 KOL

VERTETIM

Sot, me 3.6 1994 para meje Noteres u paraqit personalisht BERNARD SHKOZA, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar i cili deklaroi se sa me siper eshte sipas vullnetit te tij te lire e te plote dhe e nenshkroi sipas ligjit para meje rregullisht dhe une Noterja e vertetoj sipas ligjit rregullisht.

NOTERE

Arndon Pano

